



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

AUTORIZIM

PËR LËSHIMIN E PLOTFUQISË PËR NËNSHKRIM MARRËVESHJEJE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 5 pika 2, nenit 6, pika 1 dhe pika 3 shkronja “a”, të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, autorizoj Sh.T.Z. Edi Rama, Kryeministër dhe Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme për lëshimin e plotfuqisë për zonjën Anila Denaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë, për nënshkrimin e Marrëveshjes së Huasë shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab, për financimin e projektit të rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës.

Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet, për lëshimin e plotfuqisë, si dhe të përfaqësimit të Republikës së Shqipërisë sipas këtij Autorizimi, nuk mund të delegohen tek asnjë autoritet apo organ tjetër publik dhe ushtrimi i tyre nga autoritetet e përcaktuara në këtë autorizim është i detyrueshëm sipas ligjit.

**Nr. autorizimit 1016
Tiranë, më 28.02.2020**

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META
